



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1576/1 Prot

Tiranë, më 08.11.2019

V E N D I M

Nr.123, datë 08.11.2019

“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Shkodër , të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil, në këtë bashki”.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me verifikimin e kryer në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Shkodër,

VËREJ SE,

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit, me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (61 bashkitë e vendit), ku përfshihet edhe Bashkia Shkodër.

Verifikimi u realizuan nëpërmjet vizitës në subjekt nga grupi i inspektimit, autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim.

Nga bashkëbisedimi me përfaqësuesit e njësisë së burimeve njerëzore, informacioni që iu prezantua grupit të punës, si dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion, sipas objektit dhe drejtimeve të inspektimit rezulton si më poshtë:

Këshilli i Bashkisë Shkodër për kryerjen e funksioneve administrative të institucionit, me vendimin nr. 82, datë 20.12.2018, *“Për miratimin e buxhetit të vitit 2019 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2019-2021 të Bashkisë Shkodër”*, ka përcaktuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve në varësi për vitin 2019. Në zbatim të këtij vendimi, Kryetari i Bashkisë Shkodër, bazuar në nenin 64, shkronja “j”, të ligjit nr. 139/2015, *“Për vetëqeverisjen vendore”*, ka nxjerrë vendimin nr. 6, datë 3.1.2019 *“Për miratimin e strukturës të nëpunësve dhe punonjësve të administratës dhe institucioneve në varësi të Bashkisë Shkodër”*. Kjo është struktura në fuqi, në momentin e kryerjes së verifikimit.

Sipas strukturës aktuale, Bashkia Shkodër, së bashku me njësitë administrative në përbërje të saj, ka gjithsej **184** punonjës, të punësuar sipas procedurave të përcaktuara nga ligji për nëpunësin civil ku, **14** punonjës janë të punësuar në pozicione të kategorisë së mesme drejtuese (*drejtor drejtorie*), **26** punonjës janë të punësuar në pozicione të kategorisë së ulët drejtuese (*përgjegjës sektori*) dhe **144** punonjës janë të punësuar në pozicione të kategorisë ekzekutive. Nëpunësit civil të punësuar në pozicione të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese zotërojnë diplomë të nivelit master shkencor.

Gjatë procesit të verifikimit në subjekt, u konstatua se, të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil të zëna (**184**), janë plotësuar nga punonjës të emëruar rregullisht, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ndërsa **18** pozicione pune të shërbimit civil, rezultuan vende të lira.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, nga ana e institucionit, është vepruar në përputhje me ligjin gjatë administrimit të shërbimit civil.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, referuar Seksionit III, *“Procedura hetimore”*, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

- 1.** Të përmbillet procesi i inspektimit të kryer në Bashkinë Shkodër, pasi nuk janë evidentuar parregullsi gjatë zbatimit të ligjit për nëpunësin civil nga ana e njësisë përgjegjëse dhe e subjekteve të tjera të ngarkuara me detyra të veçanta për administrimin e shërbimit civil, në këtë institucion.
- 2.** Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Shkodër, Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Shkodër, si dhe Ministria e Brendshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha